

# HUA PËR PAJISJE SHTËPIAKE

CSN FAKTABLAD 2010 ALBANSKA

## KUSH MUND TË MERR HUA DHE PËR ÇKA?

Refugjatët dhe disa të huaj të tjerë të cilët vendosen në një banesë, mund të kërkojnë hua për pajisje shtëpiake. Për të marrë hua, duhet në mes tjerash, të jesh i/e përfshirë nga zyrat komunale të pranimit të refugjatëve, dhe duhet t'i kesh mbushur 18 vjet, atëherë kur për herë të parë je pranuar në një komunë.

Ti mund të marrësh hua nëse vendosesh në një banesë të mobiluar ose të pa mobiluar, ose nëse je duke banuar te dikush. Të hollat duhet të përdoren për të blerë pajisje kuzhine si dhe mobile, etj. Të hollat nuk guxon të përdoren p.sh. për ushqim dhe qira.

## KUR MUND TË MARR HUA?

Ti duhet ta bësh kërkesën e huas, më së voni dy vjet, pasi që për herë të parë je pranuar në një komunë. Kjo vlen edhe kur ta bësh kërkesën shtesë mbi huan e mëparshme.

## SA MUND TË MARR HUA?

Sa e lartë do të jetë huaja, varet nga madhësia e familjes, nëse banesa është e mobiluar ose e pamobiluar, dhe varet edhe nga pasuria jote vetanake. Ti mundesh gjithmonë të huazosh një shumë më të vogël se sa shumën maksimale.

Numri i personave	E pamobiluar Shuma maksimale kr.	E mobiluar/ si qiraxhi
1	15 000	5 000
2	20 000	5 000
3	25 000	5 000
4	30 000	5 000
5	35 000	5 000

Kontakto me strehimoren ose zyrën komunale për pranimin e refugjatëve. Ata të ndihmojnë me informacion si dhe të ndihmojnë ta plotësosh kërkesën e huas. Referenti pastaj e dërgon kërkesën në CSN.

## A MUND TË MARR HUA SHITESË MBI HUAN E MËPARSHME?

Ti mund të kërkoresh hua shtesë mbi huan e mëparshme nëse

- ti më herët ke marrë hua një shumë më të vogël dhe tani dëshiron ta ngritësh huan në shumën maksimale, që vlen për madhësinë e familjes dhe banimit të tanishëm
- ti shpërngulesh nga një banesë e mobiluar në një banesë të pamobiluar
- familjes i lindin fëmijë në Suedi
- një i afërm familjar i bashkëngjitet familjes, nëse ai/ajo përfshihet nga programi komunal i pranimit të refugjatëve.

Si i afërm familjar llogaritet bashkëshorti-/bashkëshortja/personi me të cilin/cilën bashkëjeton si dhe fëmijët nën moshën 21 vjeçare. Bashkëshortët/personat të cilët bashkëjetojnë marrin hua të përbashkët (edhe nëse kanë kaluar më shumë se dy vjet nga data e pranimit të parë).

Në rast shtese, për bashkëshortin/bashkëshorten/personin me të cilin/cilën bashkëjeton, atëherë jeni të dy së bashku përgjegjës për kthimin e tërë huas

## TAKSA E PLANIFIKIMIT

Një taksë planifikimi prej 300 koronash zbritet menjëherë nga huaja. Për huan shtesë, kjo shumë është 100 korona.

## SI BËHET PAGIMI ?

Pagimi i huas bëhet përmes Swedbank. Të hollat mund të paguhen në dy mënyra:

- Kartëpagesë nga Swedbank. Është një lloj çeku me të cilin i tërheq të hollat në Swedbank.
- Në xhirollogari. Mund të jetë një xhirollogari në Swedbank ose në një bankë tjetër.

*Nëse dëshiron ti kesh të hollat të futura në xhirollogari, duhet vet ta rregullosh që xhirollogaria në Swedbank të jetë e kyçur me sistemin e pagimit (SUS).*

Nëse nuk e ke kyçur xhirollogarinë me rastin e pagimit, ose nëse CSN-i nuk e ka numrin e plotë personal të marrësit, atëherë të hollat paguhen përmes kartëpagesës së Swedbanks.

## KUR DUHET KTHYER HUAJA?

Kthimi i huas fillon atë muaj kur bëhen dy vjet nga pagesa e parë.

Bashkëshortët/personat të cilët bashkëjetojnë, marrin huan e përbashkët, dhe ata së bashku kanë përgjegjësinë e kthimit të tërë huas.

## NDARJA E HUAS

CSN-i mundet të bën ndarjen e huas në rast të zgjidhjes së martesës ose ndarjes, atëherë kur të dy huamarrësit kanë rënë dakord. Huaja atëherë ndahet në dy pjesë të barabarta, dhe nuk mund të bartet në emër të njërit huamarrës. Kërkesa për ndarjen e huas duhet bërë me shkrim dhe duhet dërguar CSN-it.

Afati i kthimit është 1–15 vjet, varësisht se sa është borxhi

Borxhi i kapitalit	Afati i kthimit
< 10% nga shuma bazë	1 vit
< 40% nga shuma bazë	3 vjet
< 80% nga shuma bazë	5 vjet
< 100% nga shuma bazë	7 vjet
< 110% nga shuma bazë	8 vjet
< 120% nga shuma bazë	10 vjet
> 120% nga shuma bazë	15 vjet

(Shuma bazë për vitin 2010 është 42 400 korona)

## SI LLOGARITET KAMATA E HUAS?

Kamata caktohet çdo vit nga qeveria. Kjo llogaritet nga dita e parë kur është paguar huaja e parë. Kamata e bashkëlllogaritur për dy vitet e para që ishe i/e liruar nga kthimi i huas, i shtohet borxhit, atë ditë kur je i/e detyruar ta kthesh borxhin. Më pas llogaritet kamata vijuese, bazuar në shumën e re të përgjithshme.

Kamata gjatë vitit 2010 është 4,9 përqind.

## SI KTHEHET HUAJA?

Huaja zakonisht kthehet çdo muaj. Një herë në tre muaj merr tri fletëpagesa (nga një për secilin muaj). Një tarifë paralajmërimi që për momentin është 25 korona, duhet paguar katër herë në vit. Nëse pagesa nuk ka arritur në CSN ditën e skadimit,

atëherë muajin e ardhshëm dërgohet një rikujtesë. Tarifa e rikujtesës shtohet, e cila për momentin është 50 korona.

Me rastin e pagesës, atëherë në rend të parë zbriten tarifat e papaguara, pastaj kamata dhe së fundi kësti.

### **Pagesa vullnetare**

Ti mund të bësh pagesa vullnetare, për ta paguar borxhin më shpejt. *Pagesa bëhet në xhirollogarinë bankare nr 5201-1053 ose në plus xhirollogarinë postare nr 476 51 01-3.* Shëno numrin e huas dhe numrin personal si dhe emrin dhe adresën në fletëpagesë. Nëse dëshiron të paguash përmes internetit, atëherë duhet të përdorësh një numër-OCR të cilin mund ta porositësh nga CSN-i.

### **NËSE UNË NUK MUND TË PAGUAJ**

Nëse ti nuk mund të paguash, për shkak të ardhurave të ulëta, atëherë mund të kërkosh uljen e pagesës ose shtyrjen e afatit të pagesës (ndërprerje). Formulari të dërgohet automatikisht, së bashku me fletëpagesat e para.

Me rastin e provimit të uljes së pagesës ose shtyrjes së afatit, atëherë CSN-i merr parasysh numrin e anëtarëve të familjes si dhe shumën e përgjithshme të të ardhurave vjetore të nënshtruar detyrimit fiskal, të të dy huamarrësve.

Kamata vazhdon të llogaritet deri sa të paguhet i tërë borxhi, edhe nëse akordohet ulja e pagesës ose shtyrja e plotë e afatit të pagesës. Nëse akordohet shtyrja e plotë e afatit të pagesës, atëherë do të rritet borxhi.

Nëse banon jashtë shtetit, atëherë vlejnjë rregulla të tjera për shtyrje të afatit. Informacione më të hollësishme mund të marrësh nga CSN-i.

Ulja e pagesës ose shtyrja e afatit akordohet për një vit kalendarik.

### **A MUND TË FALET HUAJA?**

Lëshimi (falja) e huas mund t'i akordohet, pas një kërkesë paraprake, atij/asaj që ka mbi 65 vjet, ose për shkak të sëmundjes ose të metave fizike vlerësohet se plotësisht dhe përherë nuk është i/e aftë për punë.

Në rast vdekje falet huaja automatikisht.

### **UEBFAQJA**

Në uebfaqen tonë [www.csn.se](http://www.csn.se) ka informacion mbi huan tënde të pajisjes shtëpiake.

### **NDRYSHIMI I ADRESËS**

Nëse shpërngulesh brenda Suedisë, atëherë duhet lajmëruar adresën e re në amzë të popullsisë. Është mirë nëse e njofton edhe CSN-in për adresën e re.

Për adresën e re jashtë shtetit e njofton drejtpërdrejt CSN-in.

Kartela të adresës ka për t'u porositur në CSN.

### **MË SHUMË INFORMACIONE**

Më shumë informacione mund të marrësh nga:

CSN

Hemustrustningslån

851 82 SUNDSVALL

Telefoni: 0771-276 100

Orari i telefonatave: 9.00–12.00

Telefaksi: 060-18 60 06

E-posta: [hemustrustningslan@csn.se](mailto:hemustrustningslan@csn.se)

Uebfaqja: [www.csn.se](http://www.csn.se)

Kjo fletë të dhënash është e përkthyer në shqip, arabisht, anglisht, frëngjisht, kurdishten veriore, persisht, ciganisht, rumanisht, rusisht, boshnjakisht/kroatisht/serbisht, somalisht, spanjisht, kurdishten jugore, tigrine, turqisht, vietnamisht dhe badinani. Për këto përkthime përgjigjet Semantiks.

